
Gëzim AJGERAJ

HUQET E BENIT

Zvicër, Korrik 99

VOGËLUSHI BEN

Vogëlushi Ben
Me faqet si mollë
Këtu në mërgim
Ai shkon në shkollë

Është ca i llastuar
Shpesh thotë ka mërzi
Për shokët në Kosovë
Dhe gjyshin e tij

Shpeshherë babait
Ai ia tepron
Në detyra shtëpie
A në rrugë kur gabon

Cili është Beni
Unë do t'ju tregoj
Por më parë babait
Leje do t'i kërkoj

10 korrik 99

NË AEROPLAN

Në aeroplan Beni
Siç e ka zakon
Dua kokakolë
Limonadë s'kërkon

I mrrolur babai
E shikon në sy
Pse kështu mor Ben
Kola s'është për ty

Tetë stjuardesa
I solli kokakolën
E pyeti për emrin
Dhe ia lëmoi flokun

10 korrik 99

NË KOPSHT ZOOLOGJIK

Në vend të bonbones
Gurin e mbështolli
Prapa telave majmunit
Beni ia hodhi

Majmuni u hidhërua
Ia ktheu gurin prapë
Po xhaxhi kujdestar
Pranë Benit erdhi vrap

Ai me fjalë të ashpra
Benin e qortoi
Këtë ditë dhe babanë
Ai e turpëroi

Në shtëpi babai
Sa shumë u zemërua
Me sjelljet e Benit
Që u turpërua

VAZO E THYER

Beni nga ballkoni
Vazon e rrëzoi
Më prit i tha Lulit
Dhe me vrap nxitoi

Nuk i mblodhi copat
As dheun se mblodhi
Iku bashkë me Lulin
Në fushën e sportit

U hidhërua mamaja
Për dëmet që u bënë
Por më shumë babai
Për Benin çapkën

Atë mbrëmje babai
Benin e qortoi
Lulja e copëtuar
Në shportë mbaroi

5.7.99

DETYRAT E SHTËPISË

Beni me nxitim
Detyrat i mbaroi
Mandej biçikletën
Me vete e mori

Të nesërmen mësuesja Anë
Kur ia kontrolloi
Shumë gabime i gjeti
Njësh ia dhuroi

Për notën e dobët
Babai ia plasi fajin
Beni nga inati
shpejt e mori vajin

6.7.99

BENI DHE MACJA

Me thupër në dorë
Poshtë në trotuar
Herët në mëngjes
Beni sot ka dalë

Macen lara-lara
Filloi ta godasë
Ndërsa zonja Haidi
Nisi t'i bërtasë

Pasdite Haidi
Te babai shkoi
Fjalë për fjalë tregimin
ajo e tregoi

Babai i Benit
Sa shumë u turpërua
I kërkoi të falur
Zonja u largua

Në mbrëmje babai
Benin e qortoi
Ngacmimin e maces
Rreptësisht ia ndaloi

7 korrik 99

GËNJESHTRA

Një mbledhje të prindërve
Mësuesi kërkoi
Ndërsa Beni fare
Babait si tregoi

Beni çapkën djalë
Ca fjalë i dëftoi
Babi s'pati kohë
Mësuesin e mashtroi

Mësuesi i Benit
Sa shumë u zemërua
Ngriti telefonin
E vërteta u zbulua

8 korrik 99

NË AUTOBUS

Në autobus Beni
Mbahej si zotëri
Një plakë në këmbë
E shikonte me habi

Hej ti çun atje
Shoferi u zemërua
Pse nuk e lëshon vendin
Kush të ka mësuar

Beni tash kuptoi
Nga vendi u zgjua
Ulu i tha plakës
Dhe u turpërua

8 korrik 99

BENI ME BIÇIKLETË

E ngiste biçikletën
Dhe sillej vërdallë
Herë dilte në rrugë
Herë në trotuar

Por xhaxhi polic
Një ditë e hetoi
Ngasjen e biçikletës
Në rrugë ia ndaloi

U hidhërua Beni
Në xhaxhi policin
Por më shumë babai
Kur e pagoi dënimin

8 korrik 99

XHAMI I THYER

Beni nga oborri
Topin e shutoi
Atje në ballkon
Xhamin e dërmoi

Ua bëri nga frika
Filloi të ngasë
Shpejt shkoi te Luli
Gjurmët t'i humbasë

Babai i Benit
Sa shumë u mllefos
Ndërsa mamaja
Për të u brengos

Babai mori Benin
E solli në shtëpi
E qortoi rëndë
Për dëmin e tij

7 korrik 99

KUKULLA E MOTRËS

Kukullën e motrës
Në banjë e lau
Ndërsa Besa e vogël
Gjithë ditën qau

I qenë prishur flokët
Edhe në fytyrë
Ia pat shtypur faqet
Nuk i mbet as ngjyrë

Në mbrëmje babai
Benin e qortoi
Ndërsa Besës së vogël
Kukull tjetër i premtoi

8. 7. 99

QENI I VOGËL SNUPI

Erdhi në oborr
Një qen me ngjyrë hiri
Beni shpejt e kapi
Dhe në dhomë e mbylli

Kur erdhi babai
Në mbrëmje nga puna
Babit i tha Beni
Në oborr e nxura

U inatos babai
S`dua qen në banesë
Ia lexoi medaljonin
Që mbante adresë

Pastaj zonjës Tinë
Qenin ia dërgoi
I tregoi ngjarjen
Të falur i kërkoi

9 korrik 99

ZOGU DHE BENI

I shqeu pantallonat
Pas zogut në vrap
Hyri dhe në ferra
Por s`mundi ta kapë

Zogu iku qiellit
Beni në shtëpi
Sa u nevrikos
Mamaja e tij

U mbyll në shtëpi
I mërzhitur fare
Zogu e nisi këngën
Në tel mbi dritare

9.7.99

LIBRI I SHQYER

Beni në bibliotekë erdhi
librin për ta kthyer
Nga pakujdesia
Kopertinën e kish shqyer

I foli bibliotekistja
Kopertinën duke shikuar
Pse kështu mor Ben
Librin e ke dëmtuar

Beni kokën ulur
I turpëruar shkoi
Teta e bibliotekës
Babanë e lajmëroi

9.7.99

BENI DHE XHAXHAI

Një ditë në rrugë
Një xhaxha kaloi
Mirëdita çun
Benin e turpëroi

Beni uli kokën
Iku me nxitim
Ia punoi xhaxhai
Për mosrespektim

Të nesërmen babai
E kishte dëgjuar
Me sjelljen e Benit
Sa ishte turpëruar

9.7.99

VONESA

Në qytetin tonë
Mbahen karnavale
Edhe Beni i vogël
Deshi të hyjë në valle

Ai u nda nga shokët
Dhe shumë u vonua
Mamaja u mërzit
Dhe shumë u dëshpërua

Babai policinë
E ka alarmuar
Ndërsa vetë me mësuesin
Gjithkah ka kërkuar

Në mbrëmje shumë vonë
U kthye në shtëpi
E solli xhaxhi polic
Me shokët e tij

10 korrik 99

DUA ÇOKOLLATË

Nguli këmbë Beni
Dua çokollatë
Sa shumë e turpëroi
Babanë me inat

Këtë herë në shtëpi
Erdhi tezja Dritë
Po rastësisht çokollatë
Nuk pati atë ditë

Tezja Dritë inatin
Shumë shpejt ia zbuti
Me çokollata xhepin
Benit ia mbushi

11 korrik 1999

BENI DHE PESHKATARI

Peshkatarit afër grepit
Peshku iu afrua
Beni e gjuajti gurin
Dhe ai u largua

U zemërua peshkatari
Nisi t'i kërcënohej
Beni e mori ikën
Nga liqeni të largohej

U afrua babai
Falje i kërkoi
Ndërsa Benin rëndë
Ai e qortoi

Zvicër, 17.8.99

BENI NË PISHINË

Beni bashkë me Lulin
Në pishinë kanë shkuar
Pa lejen e babait
Atje për t'u freskuar

U hodh në pishinë
Notin pa e mësuar
Në ujë u fundos
Shokët e shpëtuan

Dhe babanë e Benit
Për këtë e njoftuan
Shkuarjen në pishinë
Vetëm ia ndaluan

12 korrik 99

FLETORJA E GJUHËS

Fletoren e gjuhës
Beni e ka harxhuar
Vetura e biçikleta
Polic në rrugë ka vizatuar

Papritur mësuesi
Fletoren e hetoi
Benin për shkarravina
Atë ditë e qortoi

E shihni u tregon shokëve
Beni ç'ka ka vepruar
Në fletoren e gjuhës
Ai ka vizatuar

Beni uli kokën
I turpëruar ngeli
Me gabimin e tij
E tërë klasa qeshi

13 korrik 99

KOMPJUTERI I BABAIT

Babai i thotë Benit
Me kompjuterin s'ka lojë
Me të si veprohet
Unë ty të mësoj

Beni nga merakuri
Aspak nuk duroi
E ndezi kompjuterin
Lojës ia filloi

I ka shtypur preklat
Pa pasur njohuri
E prish kompjuterin
E babait të tij

Në mbrëmje babai
Pakëz e qortoi
Pastaj kompjuterin
Në servis e dërgoi

12 korrik 99

LOJA ME BORË

Me topa bore Beni
Filloi të luajë
Besës motrës vogël
Filloi t'i gjuajë

Besa miturake
Filloi të qajë
Babi qëlloi pranë
dëgjoi një vaj

Babi më s'duroi
Pak është nevrkosur
Për mbrapshtitë e Benit
Që nuk kanë të sosur

14 korrik 99

MURET E SHKOLLËS

Beni mori shkumësin
Di të pikturojë
Në murin e shkollës
Nisi të vizatojë

Shokët e qortuan
Po ai s'i dëgjo
Shumë shpejt mësuesit
Lajmi në vesh i shkoi

E qortoi Benin
Në sjellje e dënoi
Babanë e tij
Në shtëpi e lajmëroi

Zvicër, 4.8.99

BUZË LIQENIT

Një ditë vere Beni
Buzë liqenit u ul
Dhe nisi pulëbardhat
T'i gjuajë me gur

Xhaxhi kujdestar
Benin kur e pa
Mos u gjuaj pulëbardhave
Benit ai i tha

E sheh sa të bukura
Dhe të urta janë
Bukuri e liqenit
Shoqen nuk e kanë

Beni uli kokën
I turpëruar shkoi
Xhaxhi kujdestar
Babait i tregoi

Zvicër, 30.7.99

GRUSHTAT E BENIT

Rrinte në një skaj
Beni në vetmi
Nuk dinte të flasë
Me shokët e tij

Një djalë i afrohet
Dhe nis ta përqeshë
Beni i mbledh grushtet
Dhe do t'ia ngjeshë

Një ditë nga pas shpine
Dikush e rrëzoi
Beni pa menduar
Me grushte e qëlloi

U alarmua mësuesi
Deri në drejtori
Të nesërmen në shkollë
E thirrën babin e tij

Babanë e Benit
Të gjithë e informuan
Ndërsa Benit vërejtje
Në ditar i shënuan

14 korrik 99

BENI I SËMURË

Beni dje në borë
Ditën ka rrëshqitur
Tërë natën e gjatë
Ai ka kollitur

Ka temperaturë
Shumë i digjet balli
Në mëngjes te mjeku
E dërgoi babai

E këshilloi mjeku
Përjashta mos të dalë
I dha kokrra e barna
Të pijë edhe qaj

13 korrik 99

GJYSMËVJETORI

Gjysmëvjetori
I vitit ka ikur
Me nota të dobëta
Beni ka përsëritur

Babai i Benit
Sot në shkollë ka shkuar
Suksesin e gjysmëvitit
Atje për ta dëgjuar

I nevrikosur babi
Shumë i turpëruar
Nga notat e Benit
Kur i pat dëgjuar

15 korrik 99

VONESA E BENIT

Rrugës për në shkollë
Beni kur kalon
Vitrinave të dyqaneve
Ndalet dhe shikon

I ndodhi një ditë
Diçka u hutua
Iu shfaq harresa
Në mësim u vonua

E qortoi mësuesi
Në mësim pse vonoi
Por më shumë babai
Problemin kur e kuptoi

21.7.99

TELEFONATAT E BENIT

Pa lejen e babit
Çdo ditë telefonon
Asnjëherë në mbrëmje
Atij s'i tregon

Bisedon me shokë
Nuk do të mendojë
Vallë në fund të muajit
Sa do të kushtojë

Është fundi i muajit
Shumë ka kushtuar
Është sherri Benit
Babi ka kuptuar

E uli afër vetit
Dhe shumë e qortoi
Aparatin telefonik
Atij ia ndaloi

15 korrik 99

BETIMI I BENIT

Babai nga Beni
Deshi të kërkojë
Sjelljet jo të mira
Ai t'i harrojë

Si urdhëro tha Beni
Të jap fjalën time
Që nga dita e sodit
S'do të bëj gabime

Nga ajo ditë Beni
Më kurrë nuk gabon
Sillet mirë me shokë
Dhe në shkollë mëson

14 korrik 99

NË DITËLINDJEN E BENIT

Beni për ditëlindje
Mua më ka ftuar
I mbushi të dhjetat
Ndjehet i gëzuar

Dhe xhaxhi Sokol
Bashkë me ne feston
Nganjëherë për Benin
Ai na tregon

Pasi hëngrën tortën
Ai është betuar
Do të jem i sjellshëm tha
S`kamë për të gabuar

Dhe për aventura
Unë s`do të tregoj
Për notat e mira
Benin do ta lavdëroj

10 korrik 1999

BENI NË TURNIR

Për ditën e mësuesit
Ka turnir në shkollë
Beni me shokët e klasës
Në stadium luan futboll

Ai në këtë ndeshje
Luajti për mrekulli
Turnirin e shkollës
E fitoi klasa e tij

U gëzua mësuesi
Mëmë edhe atë
Tash më gjithnjë Beni
Është çdoherë me fat

21.7.99

BENI SHUMË I MIRË

Thonë për çudi
Beni ka ndryshuar
Dhe notat në ditar
I ka përmirësuar

Sillet mirë me motrën
Dhe me shokë të tij
Shumë i sjellshëm është
Oh sa mrekulli

Biçikletë të re
Babai i ka blerë
Shumë e do mamaja
E përqafon përherë

Për fjalën që dha
E mbajti dhe s'tradhtoi
Oh sa lumturi
Të gjithë i gëzoi

15 korrik 99

BRENGOSJA E BENIT

Në një ditë vjeshte
Sa shumë binte shi
Beni shumë brengosej
Për babanë e tij

Ulur te dritarja
Edhe po shikonte
Përse po brengosej
Mamasë po i tregonte

Kthimi i babait
Sa shumë e gëzoi
Iu hodh në faqe
Dhe e përqafoi

21.7.99

DËSHIRA E BENIT

Beni dorë për dore
Shëtit me babanë
Dikush akullore
Shet në trotuar

Shumë i lakmon Benit
Po s'e thotë dot fare
Për të kërkuar akullore
Atij i vjen marre

Po babi i Benit
Ëndjen ia kuptoi
Në vend se një akullore
Dy ia pagoi

Beni i gëzuar
Shprehu falënderim
Babit i dhuroi
Puthje e përqafim

16 korrik 99

Gëzim AJGERAJ, u lind në Malësi të Vërrinit më 6 gusht të vitit 1967. Ka botuar këta libra: **1. "Klithmë malli"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1997; **2. "Ëndrra për parajsë"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1998; **3. "Qielit po digjem"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1998; **4. "Flakë në plagë"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1998; **5. "Kënga e babait"**, poezi për fëmijë, „Apolonia“, Prishtinë, 1998; **6. "Urti popullorë të Vërrinit" 1** (bashkautorësi), „Apolonia“, Prishtinë, 1998; **7. "Mallëngjimi"**, poezi, „Rilindja“, 2000; **8. "Balada e Vërrinit"**, Kl. „F. S. Noli“, Prizren, 2001; **9. "Rruga e lirisë"**, dramë, „Meshari“ Prishtinë, 2001; **10. "Rruga e lirisë" - Intervistë me Zafir Berishën**, botoi Asociacioni i Veteranëve të ish-UÇK-së – Prizren, 2002; **11. "Atdheu në trastë"**, cikël me poezi, botoi revista letrare "Jeta e re" nr. 4, korrik-gusht 2002, viti LIV. Prishtinë; **12. "Pëllumbat e lirisë"**, novelë për fëmijë, Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2004; **13. "Ditët e bardha"**, novelë për fëmijë, Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2004; **14. "Atdheu i copëtuar"**, cikël me poezi, në librin **"Pikoi molla gjak"** (Lirikë me motive arvanitase), botoi MKRSCJR-Departamenti i Çështjeve Jorezidente, Prishtinë, 2004; **15. Cikël me poezi "Udhë e zjarmi"**, në librin "Muzat i bien lyrës", Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2005; **16. "Lulëkuqet e Vërrinit"**, poezi, botoi shtëpia botuese "Metafora", Zvicër, 2005; Ka bashkëpunuar dhe bashkëpunon me të gjitha gazetat dhe revistat e kohës, si: "Rilindja", Zvicër - Prishtinë, "Bujku", Prishtinë, "Zëri i Kosovës", Zvicër - Prishtinë, "Bota sot", Zvicër, "Koha ditore", Prishtinë, "Epoka e re", Prishtinë, "Zëri", Prishtinë, "Fakti", Shkup, "Ars", Tiranë, "Pena shqiptare", Prishtinë, "Pionieri", Prishtinë, "Zogu i mëngjesit", Prishtinë, etj. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës në Prishtinë. Që nga 23 marsi 2002, është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Zvicrës (SSV). Jeton dhe vepron në Zvicër.

Libra të tjerë:

- 17. *Zana në mërgim*, poezi për fëmijë, "Metafora", Zvicër, 2006;
 - 18. *Huqet e Benit*, poezi për fëmijë, "Metafora", Zvicër, 2006;
 - 19. *Bosi lepurushi, fabula*, "Metafora", Zvicër, 2006;
 - 20. *Gjëgjeza*, "Metafora", Zvicër, 2006;
 - 21. *Dita me Tonin* (Poemë), "Metafora", Zvicër, 2006;
 - 22. *Muajt e vitit me Ardin* (Poemë), "Metafora", Zvicër, 2006;
- Që nga janari i vitit 2004, editon revistën **"Metafora poetike"**, Editorial i poetit që del në çdo tre muajt.

Gëzim Ajgeraj

Huqet e Benit

Lektor: Ilam Berisha

Ilustrimet: Toni

Radhitja kompjuterike: Ardian Ajgeraj

40 faqe: 20 cm.

Tirazhi: 500

Të drejtat e rezervuara për autorin

GA 200603-03-20